REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	**07.12.2023**
REFERENCË	
PËR:	**z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan**
Cc:	**z. Diamant Bytyqi, Nënkryetar i Komunës në Lipjan** **z. Lulzim Qerimi, Nënkryetar i Komunës në Lipjan**
NGA:	**z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit të Arsimit në Lipjan**
LËNDA:	**Raport i punës – Muaji Nëntor 01.11.2023-30.11.2023**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan edhe gjatë muajit nëntor ka kryer punë dhe detyra të ndryshme.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Më **03.11.2023** është bërë përurimi i Çerdhë së re në fshatin Shalë dhe në të njejtën ditë ka filluar edhe së funksionuari për nevojat e komunitetit.

Më datë **25.11.2024** është mbajtur Olimpiada **XV** Matematike e Kosovës-OMK 2023. Pjesë e kësaj olimpiade kanë qenë **27** nxënës nga **3** shkolla, klasa e **7,8,9,10,11** dhe **12.**

Hartimi përgatitja dhe dorëzimi i planit të prokurimit në Departamentin e prokurimit për vitin 2024.

Përgatitja tekniko-administrative e dokumentacionit për **172** studentë përfitues të bursave për vitin 2022/2023.

Më datë **25.11.2023** fëmijët e Çerdhes në Sllovi kanë vizituar drejtoratin e Arsimit me rastin e festës Kombëtare të 28 nëntorit.

Furnizimi i shkollave me:

- Më datë **06.11.2023** është bërë nënëshkrimi i marrëveshjes mes American Advising Center, qendër zyrtare e rrjetit Education USA Kosovo dhe Komunës së Lipjanit, Qëllimi i marrëveshjes është që t'u tregojmë të rinjëve rreth ofrimit të trajnimit/ punëtorisë FALAS "Këshillim për studime në SHBA dhe bursa" për nxënësit e klasave të 10-ta dhe 11-ta të Komunës tuaj.
- Më datë **23.11.2023** është bërë nënshkrimi i marrëveshjes mes Institutit Qika dhe Komunës së Lipjanit, qëllimi i nënshkrimit të marrëveshjes është realizimi i projektit “Hartimi dhe rishikimi i rregulloreve të shkollave në Komunën e Lipjanit.

Pjesëmarrja në punëtorinë:

- Të organizuar nga GIZ-i dhe Ministria e Arsimit reth digjitalizimit të shkollave,
- Të organizuar nga Shoqata Down Syndrome Kosova rreth hartimit të planit të veprimit për personat me nevoja të veqanta.

Nënalokimi në kategorinë: paga&mëditje, mallra&shërbime.

Zotimi i mjeteve në kategorinë: mallra dhe komunali.

Kërkesë Departamentit të Prokurimit për zhvillimin e procedurës për:

- Furnizimin e Çerdhës me pajisje të ndryshme

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:

- Formular për ndryshime - kthim nga lehonia, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim - skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme - ndërrim i xhirollogarisë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme (kërkesa për punësim, pushim mjekësor, pushim lehonie etj).

STATISTIKAT

Gjatë muajit nëntor nuk kemi pasur ndonjë statistikë për të paraqitur në raport mujor.

DISKUTIME PUBLIKE (Takime me qytetarë)

- Takim me përfaqësuesit e Unicef-it Takim me përfaqësuesit e UNICEF-it rreth bashkëpunimit të ndërsjelltë rreth edukimit të fëmijërisë së hershme,
- Takim me përfaqësuesit e American Advising Center, qendër zyrtare e rrjetit Education USA Kosovo themeluar nga Departamenti i Shtetit Amerikan nëpërmjet Ambasades Amerikane në Prishtinë, Kosovë ku nënshkruam marrëveshje bashkëpunimi rreth mundësisë së bashkëpunimit edhe me të thellë dhe zyrtar nëpërmjet organizatës dhe Komunës së Lipjanit. Qëllimi i këtij takimi është që t'u tregojmë rreth ofrimit të trajnimit/ punëtorisë FALAS "Këshillim për studime në SHBA dhe bursa" për nxënësit e klasave të 10-ta dhe 11-ta të Komunës tuaj.
- Takim me nxënësit e shkollave të mesme në kuadër të projektit ‘’Promovimi i Mendimit Kritik dhe Kohezionit Multietnik tek të rinjte’’ që e implementon organizata Teach For Kosova me donacion të National Endowement for Democracy (NED) dhe ka për qëllim zhvillimin e mendimit kritik dhe aktivimin tek të rinjtë.
- Takime të ndryshme me qytetarë, përkitazi me çështjet që ndërlidhen me Arsimin dhe
- Takime të vazhdueshme me drejtorët e shkollave.

SFIDAT

- Zvoglimi i numrit të nxënësve në disa shkolla,
- Risistemimi i punëtorëve arsimor të cilët humbin normat për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve dhe mbylljes së paraleleve të ndara fizik,
- Rritja e numrit të rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla, si pasojë e kësaj komisioni për vlerësimin e këtyre fëmijëve e ka të pamundur t’i vlerësoj të gjithë në kohë reale dhe
- Nevoja për angazhimin e asistenteve për nxenës me nevoja te veqanta ose realizimi i mundësisë për angazhimin e tepricës së mësuesve që mbesin pa vend pune në pozitën e asistentëve.

REKOMANDIMET

- Angazhimi i drejtorëve të shkollave për një organizim sa më të mirë të procesit edukativo-arsimor dhe
- Angazhimi i psikologeve në trajtimin e temave me rëndësi për nxënësit në të gjitha shkollat e Komunës.

ÇËSHTJE TJERA

Të gjitha punët e realizuara janë cekur në raport dhe nuk ka ndonjë çështje tjetër për të elaboruar. DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.